



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
SHKOLLA 9 – VJEÇARE LUNDËR

Nr:380 Prot

Tiranë, më 14.04.2015

NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND TË LIRE PUNE

Shkolla “9 – vjeçare Lundër”, Tiranë , në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit Nr.58, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik”, shpall njoftimin e kërkesave për konkurim, për vendin e lirë të punës në pozicionin **nëndrejtor i shkollës** në :

1. Shkolla “9 – vjeçare Lundër”, Tiranë. Të gjithë të interesuarit për këtë pozicion pune (**nëndrejtor i shkollës**), duhet të paraqesin pranë drejtorisë së Shkollës “9 – vjeçare Lundër”, Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare, sipas përcaktimeve të nenit 57 të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë).
- b) CV dhe kopje e dokumenteve që dëshmojnë pohimet në CV
- c) Tabelën e të dhënave për aplikant
- d) Raportin mjeko - ligjor.
- e) Dëshminë e masave disiplinore në fuqi .(Nëse nuk ka e deklaron me shkrim që nuk ka).
- f) Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.
- g) Deklaratën personale që vërteton që nëndrejtori nuk ka lidhje familjare me drejtorin e institucionit.

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit për konkurim , do të bëhet pranë drejtorisë së Shkollës “9 – vjeçare Lundër”, Tiranë, me adresë : Lundër , Komuna Farkë , cdo ditë nga ora 08:00 – 14:00.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit për konkurim , do të jetë data 24.04.2015 ora 14.00.

Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në drejtorinë e Shkollës “9 – vjeçare Lundër”, Tiranë, me procesverbal dorëzimi.

DREJTOR
Alma KAZIU

